




GJETJET E ANKETËS SË BUXHETIT TË FAMILJES NË SHQIPËRI

Gjetjet e Anketës së Buxhetit të Familjes në Shqipëri

- Shpenzimet mesatare mujore për konsum të NjEF në vitin 2014 llogariten të jenë 69.442 Lekë.
- Një individ në Shqipëri shpenzon mesatarisht rreth 18 mijë Lekë në muaj nga të cilat: 8 mijë Lekë për konsum ushqimor dhe 10 mijë Lekë për konsum jo-ushqimor.
- Ndonëse shtrirja kohore e krahasueshmërisë midis ABF 2009-2014 dhe ABF 2007-2009 nuk është e njëjtë, tregon se vlerësimi i shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF në vitin 2014 ishte 5,6 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2009 ndërsa vlerësimi i shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF në vitin 2009, i krahasuar me vitin 2007 ishte 5,2 përqind më i ulët.
- Shpenzimi mesatar për frymë për konsum ushqimor ndaj shpenzimeve gjithsej në vitin 2014, ulet nga 50 përqind në vitin 2009, në rreth 44 përqind në vitin 2014.
- Shpenzimet për ushqime dhe pije jo-alkoolike kryesojnë në buxhetin familjar duke zënë 44,3 përqind të tij brenda të cilave tre janë nëngrupet që zënë peshën më të madhe: “mish dhe nënprodukte”, “bukë dhe drithëra”, “qumësht me nënproduktet e tij dhe vezë” me rreth 20 përqind të buxhetit.
- NjEF në Shqipëri shpenzojnë 10,2 përqind të buxhetit total për qira të paguar, ujë, energji elektrike, lëndë djegëse dhe riparime të vogla të banesës.
- Ndër shpenzimet për arsim të cilat zënë 4,2 përqind të buxhetit gjithsej, peshën më të madhe e zënë pagesat në lidhje me kategorinë “Master (niveli i parë dhe i dytë)”, me 58,8 përqind.
- Pothuajse të gjitha shpenzimet e kryera nga NjEF për komunikim, të cilat zënë 3,3 përqind të buxhetit familjar, kryhen për shërbime telefonike, rreth 97 përqind, ndërsa për shërbime postare vetëm 3 përqind.

Gjetjet e Anketës së Buxhetit të Familjes në Shqipëri

- Në vitin 2014, qarqet që i dedikojnë pjesë më të madhe të buxhetit total, shpenzimeve për ushqime dhe pije jo-alkoolike janë Dibra me 49,2 përqind dhe Vlora me 49,1 përqind, ndërsa në vitin 2009 ishte qarku i Durrësit me 61,0 përqind.
- Në vitin 2014, qarku që i dedikon pjesë më të madhe të buxhetit total, shpenzimeve për pije alkoolike dhe duhan është Dibra me 6,0 përqind, ndërsa në vitin 2009 ishte qarku i Vlorës me 6,1 përqind.
- Në vitin 2014, qarku që i dedikon pjesë më të madhe të buxhetit total, shpenzimeve për veshje dhe këpucë është Tirana me 6,6 përqind, ndërsa në vitin 2009 ishte qarku i Kukësit me 6,7 përqind.
- Në vitin 2014, qarku që i dedikon pjesë më të madhe të buxhetit total, shpenzimeve për banesën, është Dibra me 12,5 përqind, ndërsa në vitin 2009 ishte qarku i Tiranës me 11,1 përqind.
- Në vitin 2014, qarku që i dedikon pjesë më të madhe të buxhetit total, shpenzimeve për mobilim, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje të zakonshme të banesës është Kukësi me 8,0 përqind, ndërsa në vitin 2009 ishte qarku i Gjirokastrës me 6,9 përqind.
- Në vitin 2014, qarku që i dedikon pjesë më të madhe të buxhetit total, shpenzimeve për shëndet është Berati me 6,4 përqind ndërsa në vitin 2009 ishte qarku i Lezhës me 4,2 përqind.
- Në vitin 2014, qarqet që i dedikojnë pjesë më të madhe të buxhetit total shpenzimeve për transport janë Tirana dhe Vlora me nga 7,7 përqind ndërsa në vitin 2009 ishte qarku i Fierit me 5,8 përqind.
- Në vitin 2014, qarqet që i dedikojnë pjesë më të madhe të buxhetit total shpenzimeve për komunikim, janë Vlora dhe Kukësi me nga 4,3 përqind ndërsa në vitin 2009 ishin qarqet e Tiranës dhe Beratit me nga 4,1 përqind.
- Në vitin 2014, qarku që i dedikon pjesë më të madhe të buxhetit total, shpenzimeve për argëtim dhe kulturë është Lezha me 4,4 përqind ndërsa në vitin 2009 ishte qarku i Gjirokastrës me 4,0 përqind.



Gjetjet e Anketës së Buxhetit të Familjes në Shqipëri

- Në vitin 2014, qarku që i dedikon pjesë më të madhe të buxhetit total, shpenzimeve për restorante dhe hotele është Berati me 5,7 përqind ndërsa në vitin 2009 ishte qarku i Dibrës me 7,1 përqind.
- Në vitin 2014, shpenzimet mesatare mujore më të larta të NjEF sipas nivelit arsimor të përfunduar të kryefamiljarit rezultojnë në qarkun e Lezhës dhe për familjet ku kryefamiljari ka arsim të lartë dhe pasuniversitar, rreth 149 mijë Lekë.
- Shpenzimet mesatare për transport, vlerësohen në rreth 6 mijë Lekë në muaj për NjEF të përbëra nga dy apo më shumë të rritur dhe fëmijë.
- 90 përqind e NjEF shpenzon 78,5 përqind të vlerës së konsumit gjithsej, me një mesatare të shpenzimeve për konsum prej 60.548 Lekë në muaj për NjEF, ndërsa 10 përqindëshi tjetër i NjEF shpenzon 21,5 përqind të konsumit gjithsej me një shpenzim mesatar prej 149.510 Lekë në muaj për NjEF.
- Shpenzimet mesatare të konsumit për frymë për shumicën e popullsisë që korrespondon me 90 përqind të NjEF, janë 16.746 Lekë në muaj ndërsa për pjesën tjetër të popullsisë që korrespondon me 10 përqind të NjEF me shpenzimet më të larta, janë 61.047 Lekë në muaj ose 3.6 herë më shumë.